

Miftar KURTI

**DEMILITARIZIMI I USHTRISË ÇLIRIMTARE TË
KOSOVËS DHE TRANSFORMIMI I SAJ NË TRUPAT
MBROJTËSE TË KOSOVËS**

Paraqitja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), fillimisht përmes komunikatave e dikur edhe përmes aksioneve ushtarake, pati jehonën dhe ndikimin e vet në opinionin e brendshëm dhe të jashtëm. Ajo kishte zgjuar aq shumë kureshtjen sa nuk kishte zyrë as diplomat e politikan në Parlamentin dhe në Unionin Evropian, i cili nuk shtronte pyetjen nëse ekzistonte vërtet “Ushtria Çlirimtare e Kosovës”. Edhe pse, ç’është e vërteta, shkresat dhe telefonatat mbi marrjen e autorësisë për sulmet e UÇK-së në fund të prillit 1996 në Kosovë, kishin arritur në të gjitha këto institucione.¹ Mirëpo, paraqitja e saj publike më 28 nëntor 1997, në fshatin Llaushë të Drenicës, me rastin e varrimit të mësuesit Halit Geci, i cili ishte vrarë nga forcat jugosllave, përfundimisht hoqi “mjegullën” dhe dilemat rreth ekzistencës së saj.² Opinionet, mendimet, pikëpamjet dhe deklaratat për këtë organizatë politiko-ushtarake ishin të ndryshme, shpesh kontradiktore, bile në disa raste ishin shumë negative, nga evropianët edhe nga amerikanët. Derisa raportuesi special i SHBA-së, Robert S. Gelbard, gjatë një konference për shtyp, më 22 shkurt 1998, në Prishtinë, sulmet e UÇK-së kundër policisë serbe i quante terroriste³, kurse zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, James P. Rubin, në një

¹ *Ushtria Çlirimtare e Kosovës - Dokumente dhe artikuj*, përgatitur për botim nga Gafurr Elshani, Botimi i dytë, Botues/Verlager: Zëri i Kosovës, Indistriestrade 44/5000 Arau/CH, 1998, f. 78-79.

² Ksenofon Krisafi, “Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe faktori ndërkombëtar”, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës-vlerë kombëtare*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 2022, f. 45-46.

³ https://1997-2001.state.gov/policy_remarks/1998/980222_gelbard_pristina.html
Qasja: 20.12.2022.

deklaratë për shtyp më 2 mars 1998, u bënte “thirrje liderëve shqiptarë të Kosovës që të dënojnë veprimet terroriste të të ashtuquajturës UÇK”⁴, atëherë raportuesi special i OKB-së për të drejtat e njeriut në Republikën Federative të Jugosllavisë (RFJ), Jirzhi Dirnstbir, për radion *Dojçe Vele*, 21 shtator 1998, kishte deklaruar se UÇK-ja “është turpi dhe tragjedia më e madhe për shqiptarët”.⁵ Përtej këtyre deklarimeve të kësaj natyre, “Ushtria Çlirimtare e Kosovës më vonë do të veçohet si lëvizja e parë kryengritëse e suksesshme në Evropë, që nga Lufta e Dytë Botërore”⁶, do të vlerësohet si njëra prej kryengritjeve më të suksesshme të periudhës së pas Luftës së Ftohtë, por edhe do të cilësohet si një revolucionarist nacionalist”.⁷ Me veprimtarinë e saj, UÇK-ja do t’i imponohej zyrtarisht dhe juridikisht edhe vetë Beogradit. Kjo kishte ndodhur më 13 janar 1999, atëherë kur midis autoriteteve drejtuese të UÇK-së dhe atyre serbe, u krye një shkëmbim robërisht. Veprimi, i zakonshëm në pamje të parë, mund të konsiderohet si njohje zyrtare e saj nga Serbia, pranimi i saj si faktor me statusin juridiko-ndërkombëtar të palës ndërluftuese ose palës kryengritëse⁸. Falë veprimtarisë së saj, ishte organizuar edhe një Konferencë Ndërkombëtare për Kosovën, siç ishte Konferenca e Rambujesë. Sipas diplomatit dhe historianit prof. dr. Paskal Milo: “Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Konferenca e Rambujesë nuk mund të kuptohen pa njëra-tjetrën... UÇK-ja u vendos në qendër të punimeve të Konferencës, por edhe të diplomacisë dhe të medias ndërkombëtare. Ajo u bë objekt analizash të burokracive diplomatike jo vetëm të gjashtë qeverive të vendeve të Grupit të Kontaktit, por shumë më gjerë, të vendeve evropiane, rajonale, të NATO-s, të Këshillit të Sigurimit të OKB-së”.⁹ Prandaj, me të drejtë është thënë se Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kishte përmasa historike, nëse për asgjë tjetër, edhe për faktin se ishte pranuar në nivelet më të larta ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjes

⁴ <https://1997-2001.state.gov/briefings/statements/1998/ps980302b.html> Qasja: 19.12.2022.

⁵ Fehmi Baftiu, *Kosova krizë ndërkombëtare, Çlirimi*, Prishtinë, 2004, f. 162.

⁶ James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, Onufri, Tiranë, 2013, kopertina e librit.

⁷ Henry H. Perrit Jr., *Ushtria Çlirimtare e Kosovës-rrëfim prej brenda për një kryengritje*, Koha, Prishtinë, shtator 2008, f. 8, 14.

⁸ Krisafi, “Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe faktori ndërkombëtar”, f. 45-46.

⁹ Pskal Milo, “Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Konferenca e Rambujesë”, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës-vlerë kombëtare*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 2022, f. 24, 25.

shqiptare.¹⁰ Duke qenë se UÇK ka kryer me sukses misionin historik, pra çlirimin e Kosovës, atëherë kur të shkruhet për të është e nevojshme të trajtohet edhe çështja e demilitarizimit dhe transformimit të saj në Trupat Mbrotjtëse të Kosovës. Kjo përbën fokusin e këtij punimi.

Marrëveshja për demilitarizimin e UÇK-së

Për mendimin tim fillesat e demilitarizimit të UÇK-së duhet kërkuar në Konferencën e Rambujesë, sepse në dokumentin e marrëveshjes ishte përfshirë edhe kjo çështje. Kjo Konferencë shënon hapin e parë në këtë aspekt.¹¹ Që nga momenti kur filloi fushata ajrore e Forcave Aleate kundër Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ) së Millosheviqit, qeveritë e aleancës ishin thellësisht të shqetësuara për statusin e ardhshëm të UÇK-së, edhe pse ajo kishte pranuar parimin e çmilitarizimit kur përfaqësuesit e saj nënshkruan marrëveshjen e Rambujesë. Megjithatë, marrëveshja për demilitarizim dhe transformim të UÇK-së erdhi pasi NATO-ja zyrtarisht përfundoi fushatën ajrore dhe pasi të gjitha njësitë ushtarake dhe policore të Republikës së Jugosllavisë u larguan nga Kosova (qershor 1999).¹² “*Demilitarizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*” ishte paraparë edhe me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 10 qershor 1999.¹³

Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe komandanti i forcës ndërkombëtare të paqes në Kosovë (KFOR) nënshkruan më 20 qershor 1999, pak pas mesnate, në Prishtinë, marrëveshjen për demilitarizimin e menjëhershëm dhe çarmatosjen graduale të UÇK-së. Ceremonia e shkurtër e nënshkrimit të marrëveshjes mes gjeneralit Majk Xhekson dhe liderit politik të UÇK-së, Hashim Thaçi, u zhvillua në një tendë të vogël në

¹⁰ Emin Kabashi, “Përmasa kombëtare e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës-vlerë kombëtare*, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 2022, f. 84.

¹¹ Assemblée Nationale - Séance du 04/10/1999 : N° 2022. *Raport i Informacionit nga Komisioni i Mbrojtjes Kombëtare dhe Forcave të Armatosura në Asamblenë Kombëtare* prezantuar nga MM Paul QUILÈS dhe François LAMY, 15 dhjetor 1999, Données originales sur: <https://www.assemblee-nationale.fr/legislatures/11/pdf/rap-info/i2022.pdf>, mise à jour du Qasja: 13.04.2021.

¹² <https://www.theguardian.com/world/1999/jun/21/balkans3> Qasja: 19.12.2022

¹³ https://www.nato.int/cps/fr/natohq/topics_49602.htm;

<https://www.nato.int/kosovo/repo2000/index.htm> Qasja: 8.10.2022.

Shtabin e KFOR-it në periferi të Prishtinës.¹⁴ Arritja e marrëveshjes i kishte dhënë fund shqetësimeve në rritje të aleatëve. Nënshkrimi i marrëveshjes “është një arritje shumë e rëndësishme”, kishte deklaruar për gazetarët presidenti francez Zhak Shirak.¹⁵ Arritjen e marrëveshjes e kishin konfirmuar dhe mirëpritur edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Teksti i marrëveshjes ishte dërguar në Bruksel për miratim nga anëtarët e NATO-s.¹⁶ Arritja e marrëveshjes ishte mirëpritur edhe nga gjenerallejtnant Majk Xhekson, komandant i Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë në Kosovë (COMKFOR), sepse “mishëronte dëshirën e UÇK-së për të përbushur kërkesat e çmilitarizimit të përcaktuara në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, por edhe pasqyronte gjithashtu aspiratat e UÇK-së për të luajtur një rol në Kosovë”.¹⁷ Mirëpo, ky tekst i marrëveshjes, sipas gjeneralit Xhekson “...në asnjë mënyrë nuk është marrëveshje e negociuar, e llojit të asaj të nënshkruar në Kumanovë me ushtrinë federale jugosllave”¹⁸.

Në *Marrëveshjen për Demilitarizimin dhe Transformimin e UÇK-së*¹⁹, të nënshkruar më 20 qershor 1999, bien në sy disa detaje, disa pika. Në pikën 1 të Marrëveshjes thuhet se ky tekst është një Iniciativë që “...mundëson armëpushim të UÇK-së, mosangazhim të saj në zonat e konfliktit...”, në pikën 2 thuhet se “UÇK-ja merr iniciativë, që të heqë dorë nga përdorimi i forcës, që t’i përbushë direktivat e Komandantit të forcës ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë (COMKFOR) dhe që në mënyrë paqësore t’i zgjidhë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me implementimin e kësaj marrëveshje”.²⁰ Në pikën 22 të saj, ishte paraparë

¹⁴ https://www.lemonde.fr/archives/article/1999/06/22/l-uck-signe-un-accord-de-demilitarisation_3580099_1819218.html Qasja: 8.10.2022

¹⁵ Pilar Bonetjavier Moreno, *El ELK se compromete con la fuerza de paz a desmilitarizarse*, Colonia - 21 JUN 1999 - 00:00 CEST

(https://elpais.com/diario/1999/06/21/internacional/929916007_850215.html) Qasja: 19.12.2022

¹⁶ <https://www.elmundo.es/elmundo/1999/junio/20/internacional/kosovo.html> Qasja: 19.12.2022.

¹⁷ <https://www.nato.int/docu/revue/1999/9903-05.htm> Qasja: 19.12.2022.

18 par Didier FRANÇOIS, Pristina, envoyé spécial, *KOSOVO. L'UCK dépose armes et uniformes. L'accord avec la Kfor prévoit une «totale démilitarisation»*.

(https://www.liberation.fr/planete/1999/06/22/kosovo-l-uck-depose-armes-et-uniformes_275582/) Qasja: 19.12.2022.

¹⁹ Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovë nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, f. 319-326.

²⁰ Po aty, f. 319.

formimi i një Komisioni të Përbashkët për Implementimin (KPI). Ai Komision do të vendoset në Prishtinë brenda katër ditësh, pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe do të udhëhiqet nga Komandantit i KFOR-it (COMKFOR), mirëpo pjesë të këtij Komisioni do të jenë edhe komandantë të lartë të KFOR-it dhe UÇK-së si dhe një përfaqësues i administratës civile ndërkombëtare në Kosovë.²¹ Një pikë tjetër thelbësore e marrëveshjes për demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së, ishte paragrafi 25b, ku ndër të tjera thuhet se do të bëhet: “Formimi i Ushtrisë së Kosovës në vijat e Gardës Kombëtare të SHBA-së, si pjesë e procesit politik e cila do të duhet të vendosë për statusin e Kosovës, duke marrë parasysh Marrëveshjen në Rambuje²²”.

UÇK-ja, ndër të tjera, me anët të kësaj marrëveshjeje ishte zotuar se nuk do ta pengonte misionin e forcës paqeruajtëse të udhëhequr nga NATO-ja; kishte marrë përsipër që menjëherë t’i ndërpresë të gjitha operacionet luftarake, që t’i braktisë të gjitha pozicionet ushtarake, llogoret dhe pikat e kontrollit rrugor etj. Po ashtu kishte pranuar që brenda shtatë ditëve të bënte ngritjen e depove të sigurta të armëve në mënyrë që të kontrollohen edhe nga trupat e NATO-s; që brenda 30 ditëve t’i dorëzojë të gjitha armët dhe t’i vendos në depot e regjistruara, kurse brenda 90 ditëve të përfundojë procesi i demilitarizimit.²³ Kësisoj, UÇK-ja kishte luajtur një rol shumë të rëndësishëm, vendimtar, për lirinë dhe paqen në Kosovë. Këtë e ka pohuar edhe zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, James Rubin, i cili në muajin qershor 1999, me rastin e arritjes së marrëveshjes kishte deklaruar se: “UÇK-ja ka dhënë një kontribut vendimtar për paqen, për demokracinë”.²⁴

Transformimi i UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës

Aq sa ishte sfidues procesi i demilitarizimit të UÇK-së, po aq sfidues ishte edhe procesi i transformimit të saj në Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Nëse krerët e UÇK-së kishin pranuar demilitarizimin e UÇK-së, ata ishin kundër zhbërjes së saj. Drejtori i Drejtorisë Politike, Hashim

²¹ Po aty, f. 323.

²² Po aty, f. 325.

²³ <https://www.bndlg.de/~wplarre/back250.htm> Qasja: 19.12.2022

²⁴ Didier François, Pristina, envoyé spécial, *KOSOVO. L'UCK dépose armes et uniformes. L'accord avec la Kfor prévoit une «totale démilitarisation»*.

(https://www.liberation.fr/planete/1999/06/22/kosovo-l-uck-depose-armes-et-uniformes_275582/) Qasja: 19.12.2022.

Thaçi, nuk kishte pranuar në asnjë mënyrë zhbërjen totale të UÇK-së, por transformimin e saj në një forca sigurie të tipit të Gardës Kombëtare Amerikane²⁵. Edhe shumica e komandantëve ishin thellësisht të pakënaqur me perspektivën e transformimit të UÇK-së në organizatë civile, për këtë arsye, njëri prej tyre, Ramush Hajredinaj, kishte munguar në takimin me gjeneralin Uesli Klark.²⁶ Negociatat për transformimin e UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) u zhvilluan në një atmosferë të tensionuar. Për gjetjen e një solucioni të pranueshëm për të gjithë ishin angazhuar: Hashim Thaçi, përfaqësuesi i Misionit të Administrimit Civil në Kosovë (UNMIK), z. Bernard Kushner, komandanti i NATO-s, gjenerali Wesli Klark, komandanti i KFOR-t, gjenerali Majk Xhekson, komandanti i UÇK-së, gjeneral Agim Çeku dhe komandantët e shtatë zonave operative. Ngase arritja e marrëveshjes nuk po arrihej dot, ishte dashur ndërhyrja e befasishme në negociatat në selinë e KFOR-it në kryeqytetin e Kosovës, e komandantit suprem të NATO-s në Evropë, gjenerali amerikan Uesli Clark për t'u arritur marrëveshja.²⁷ Duket se një nga pikat kryesore që pengonte arritjen e marrëveshjes kishte të bënte me emrin që duhej ta mbante organizata, e cila do ta pasonte UÇK-në. Kështu, në vend që të quhej Korpusi i Kosovës, ashtu siç kërkonte NATO, u vendos që të quhet Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), ashtu siç kishin kërkuar udhëheqësit shqiptarë të UÇK-së²⁸. Mirëpo, në vend se të formohej një organizatë e ngjashme me Gardën Kombëtare Amerikane, siç ishte paraparë në paragrafin 25b të Marrëveshjes për demilitarizim dhe transformim, u formua një organizatë që më shumë i ngjante modelit francez *Security Civile*. Duket se ky ishte kompromisi që mundësoi arritjen e marrëveshjes. Përkundër të gjitha sfidave, si rezultat i *Marrëveshjes për demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së*, u formuan Trupat Mbrojtëse të Kosovës, ku një numër i pjesëtarëve të UÇK-së u inkuadruan në radhët e saj, u formua Partia e Progresit Demokratik të Kosovës (PPDK), që më vonë u quajt Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kurse pjesëtarë të tjerë u inkuadruan në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK). Kështu thuhet në Raportin e Grupit Ndërkombëtar të

²⁵ Bedri Zyberaj, *TMK-së i duhet përkujdesje institucionale, Intervistë me Hashim Thaçin ish-drejtor i Drejtorisë Politike të UÇK-së*, Revista e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, nr. 1, nëntor-dhjetor 2000, f. 6.

²⁶ By R. Jeffrey Smith, *NATO, Kosovo Rebels Reach Accord*, Washington Post Foreign Service Tuesday, September 21, 1999, Page A1.

²⁷ *Der Spiegel*, 21.06.1999.

²⁸ By R. Jeffrey Smith, *NATO, Kosovo Rebels Reach Accord*, Washington Post Foreign Service Tuesday, September 21, 1999, Page A1.

Krizave, me titull “Çfarë ka ndodhur me UÇK-në?”, publikuar më 3 mars 2000.²⁹ Duke qenë se me Rezolutën 1244, miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së në mbledhjen 4011, më 10 qershor 1999, ku në Pikën 9b parashihet Demilitarizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)³⁰; duke qenë se demilitarizimi i UÇK-së ishte edhe pjesë e Marrëveshjes së Rambujesë, atëherë përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), Bernar Kushner, në përputhje me autorizimin që i ishte dhënë me Rezolutën 1244, më 20 shtator 1999, e kishte shpallur publikisht *Themelimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës*³¹.



Figura 1. Udhëheqësi i UÇK-së, Hashim Thaçi, Bernard Kouchner i OKB-së, gjenerallejtënant britanik Mike Jackson, shefi i Shtabit të UÇK-së Agim Çeku dhe gjenerali amerikan Wesley Clark, bashkohen në ceremoninë e nënshkrimit. (EPA)³²

Edhe pse procesi i transformimit të UÇK-së në TMK ishte shumë i vështirë, ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, gjeneralejtant

²⁹ <https://www.refworld.org/docid/3ae6a6df0.html> Qasja: 19.12.2022.

³⁰ Agjencia Shtetëror e Arkivave të Kosovës (ASHAK), Fondi: Trupat Mbrojtëse të Kosovë, Dosja Drejtorati për Mbrojtje Civile i KB-së-Zyra e Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

³¹ Rregullore për Themelimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovë, nr. 1999/8, 20 shtator 1999; By R. Jeffrey Smith, *NATO, Kosovo Rebels Reach Accord*, Washington Post Foreign Service Tuesday, September 21, 1999, Page A1;

<https://www.nato.int/kosovo/press/1999/k990921b.htm> qasja 19.12.2022.

³² By R. Jeffrey Smith, *NATO, Kosovo Rebels Reach Accord*, Washington Post Foreign Service Tuesday, September 21, 1999, Page A1.

Agim Çeku, deklaroi se në nxorëm optimumin e asaj që mund të nxirrej nga një marrëveshje.³³ Sipas kryeadministratorit të UNMIK-ut, Bernard Kushner, me formimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, formacioni ushtarak i organizuar për luftë (UÇK-M.K.), u transformua në strukturë të dedikuar për veprimtari paqësore. Sipas njohurive të mia, deklaronte Kushner, në histori ky është transformimi i parë i këtij lloji³⁴. Kurse sipas ish-komandantit të UÇK-së, gjeneral Sylejman Selimi, marrëveshja për transformimin e UÇK-së në TMK, nuk përputhej me synimet tona, por është me rëndësi fakti që ajo linte hapur rrugët për realizimin e këtyre synimeve³⁵. Ndërkaq, sipas kolonelit Tahir Sinani, ish-komandant i Zonës Operative të Pashtrikut, dita e transformimit të UÇK-së në TMK, është hapi i parë drejt krijimit të Sistemit të Mbrojtjes së Kosovës³⁶.

Bazuar në *Marrëveshjen për demilitarizim të UÇK-së*, me qëllim të detajizimit të masave, të cilat do të ndërmerreshin për përfundimin e suksesshëm të demilitarizimit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, gjenerallejtnant Agim Çeku, më 15 shtator 1999, kishte lëshuar *Urdhrin* për përfundimin e procesit të demilitarizimit, sipas të cilit: të gjitha armët, përpos atyre që përdorreshin për të ruajtur zonat e grumbullimit dhe depot e armatimit, duhet të deponoheshin në depot e armatimit³⁷. Kësisoj, nga mesnata e 19 shtatorit 1999, sigurinë e zonave të grumbullimit e garantonte edhe KFOR-i. Për t'i asistuar KFOR-it në sigurimin e zonave të grumbullimit, 6 armë mbaheshin në çdo zonë grumbullimi për detyrë të rojës, kurse llojet dhe numrat e armëve duhej t'i dorëzoheshin Shtabit të Përgjithshëm (SHP) deri në mesditën e 18 shtatorit. Pas mbylljes së zonës së grumbullimit, sipas urdhrin, armët deponoheshin në depot e armatimit. Sipas të njëjtit urdher, pas mesnatës së 19 shtatorit, pjesëtarët e UÇK-së nuk do të mund të bartnin më uniforma me shenjat e UÇK-së, përveç uniformës dhe shenjës dalluese të Korpusit të Kosovës (KK). Uniformat ushtarake mund të barteshin në zonat e grumbullimit, por pa shenjat e UÇK-së. Po ashtu, pas kësaj date, nuk mund të përdorreshin as makinat ushtarake me shenja dhe dokumente të UÇK-së, përveç atyre me dokumente të KK. Gjithashtu nuk lejohej as pjesëmarrja me uniforma në

³³ *Rregullore për Themelimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës*, nr. 1999/8, 20 shtator 1999.

³⁴ Bedri Zyberaj, *TMK-në i Kosova ka krijuar bazën e sistemit të mbrojtjes*, "Mbrojtja e Kosovës", Revista e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, nr. 1, nëntor-dhjetor 2000, f. 4.

³⁵ Po aty, f. 5.

³⁶ Po aty, f. 5.

³⁷ Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Shtabi i Përgjithshëm, *Urdhëresë për përfundimin e procesit të demilitarizimit*, nr. prot. 436, datë 15.09.1999.

rivarrimet e Dëshmorëve të Kombit, nuk lejoheshin as të shtëna nderi në shenjë nderimi për të rënë pa lejen e KFOR-it, leje e cila duhej të kërkohej të paktën 24 orë më herët. Pjesëtarëve të UÇK-së, sipas kësaj urdhërese, iu afrohej mundësia të bëheshin pjesë e Korpusit të Kosovës (KK), që do të njihet si TMK, nëse i plotësonin kushtet; në Shërbimin Policor të Kosovë (SHPK) nëse paraqiteshin me kohë ose me ndihmesën e IOM-it.³⁸

Në procesin e transformimit të UÇK-së në TMK ishte përfshirë edhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Sipas Urdhëresës për regjistrim të ushtarëve në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, të gjithë pjesëtarët e UÇK-së (përveç komandave të zonave dhe oficerëve të lartë), që dëshironin të inkuadroheshin në TMK, duhet të paraqiteshin në cilëndo zyrë të IOM-i dhe të mbushnin fletëparaqitjet deri më 26.10.1999. Regjistrimi i pjesëtarëve të komandave të zonave të mbrojtjes, si dhe për oficerët e lartë të zonave bëheshin në komanda të zonave të mbrojtjes, sipas këtij orari: Zona V Mbrojtëse (13.10.1999) në Prishtinë, Zona VI Mbrojtëse (14.10.1999) në Gjilan, Zona II Mbrojtëse (15.10.1999) në Prizren, Zona III Mbrojtëse (16.10.1999) në Pejë, Zona IV Mbrojtëse (18.10.1999) në Mitrovicë, Zona I Mbrojtëse (19.10.1999) në Skënderaj. Për Gardën e Kosovës dhe Shtabin e Përgjithshëm, regjistrimi organizohet më 20.10.1999 në Prishtinë. Me rastin e regjistrimit zyrtar në IOM lëshohej një letër identifikimi i përkohshëm me titull “Korpusi i Kosovës”, i cili ishte i përkohshëm, kurse me rastin e nënshkrimit të kontratës lëshohej letërnjoftimi zyrtar i përkohshëm, me emblemë dhe simbol të TMK-së.³⁹

Sfidat për konsolidimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës

Meqë Trupat Mbrojtëse të Kosovës u formuan si rezultat i kompromiseve jo të lehta politike dhe, sidomos, duke pasur parasysh Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, në bazë të të cilës u vendos pushteti civil ndërkombëtar në Kosovë, TMK nuk mund të kryente detyra të sigurisë, atëherë pushtetin ushtarak dhe të sigurisë e mori NATO, përkatësisht KFOR-i.⁴⁰ Në *Rregullore për Themelimin e Trupave*

³⁸ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP.

³⁹ Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Fondi: TMK, Dosja SHP, *Urdhëresë për regjistrimin e ushtarëve në Trupat Mbrojtëse të Kosovës*, nr. prot. 037, 12.10.1999, Prishtinë.

⁴⁰ Grup autorësh, *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Prizren, 2001, f. 390.

Mbrojtëse të Kosovës, nr. 1999/8, 20 shtator 1999, të nënshkruar nga përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), Bernar Kushner, janë përcaktuar misioni, detyrat, obligimet, përgjegjësitë e TMK-së. Kështu, Neni 1, pika 1.1, thotë:

Trupat Mbrojtëse të Kosovës themelohen si agjenci civile e shërbimit emergjent, detyra e të cilave do të jetë: a) *Të sigurojnë shërbime në raste të fatkeqësive natyrore; b) Të bëjnë kërkimin dhe shpëtimin e të rrezikuarve; c) Të ofrojnë mundësitë e vet për ndihma humanitare në zonat e izoluarra; d) Të ndihmojnë për çminimin e zonave të minuara; dhe e) Të kontribuojnë në rindërtimin e infrastrukturës dhe të komuniteteve.*⁴¹

Trupat Mbrojtëse të Kosovës përbëheshin nga 3 000 pjesëtarë aktivë dhe 2 000 rezervë. Këta të fundit mund të thirrreshin (mobilizohen) nëse e kërkonte nevoja. Pjesëtarët e saj rekrutoheshin individualisht, në bazë të kriterëve profesionale. Të paktën 10 për qind e numrit të anëtarëve aktivë dhe rezervë duhej të përbënin grupet minoritare. Përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) e kishte fjalën përfundimtare për zgjedhjen dhe emërimin e pjesëtarëve të TMK-së si dhe për shkarkimin e tyre. Pjesëtarët e TMK-së nuk lejoheshin të merrnin pjesë në asnjë veprimtari politike dhe nuk lejoheshin të kryenin detyra publike as të angazhoheshin në mënyrë aktive në politikë. Trupat Mbrojtëse të Kosovës vepronin nën autoritetin e përfaqësuesit special të Sekretarit të Përgjithshëm, kurse KFOR-i jepte udhëzime për funksionimin e përditshëm të TMK-së në përputhje me politikën dhe përparësitë e përcaktuara nga PSSP.⁴²

Procesi i përzgjedhjes së pjesëtarëve kishte filluar më 23 korrik dhe kishte zgjatur deri në nëntor 1999. Gjatë kësaj periudhe ishin regjistruar afërsisht 25 723 pjesëtarë të UÇK-së të paraqitur në 49 pika zyrtare, kurse më vonë në pika rajonale të regjistrimit në tërë Kosovën. Fillimisht për përzgjedhjen dhe selektimin e pjesëtarëve për TMK përgjegjës ishte Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), e cila për pesë muaj testoi mbi 20 271 aplikues, prej tyre 17 348 ish-luftëtarë të UÇK-së, 2 923 civilë dhe 96 minoritarë të interesuar për të qenë pjesëtarë të TMK-së. Komisioni përzgjedhës përbëhej nga përfaqësues të UNMIK-ut, Forcës së Kosovës (KFOR) dhe udhëheqës të lartë të TMK-së.⁴³

⁴¹ *Rregullore për Themelimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës*, nr. 1999/8, 20 shtator 1999.

⁴² *Rregullore NR.1999/UNMIK/RREG/1999/8*, 20 shtator 1999.

⁴³ Historia e TMK-së, *Doracak i Akademisë së Mbrojtjes (Komanda e Doktrinës dhe Shërbimeve)*, Prishtinë, f. 13,14.

Edhe pse në marrëveshjet dhe rregulloret në fuqi thuhej se TMK-ja është organizatë emergjente për të reaguar ndaj fatkeqësive që e godasin popullatën dhe territorin e Kosovës, ajo në gjirin e vet ngërthente shumë elemente të organizimit ushtarak. TMK kishte strukturë ushtarake, kishte emblemën, uniformën; kishte komandantin, zv/komandantin, shefin e Shtabit të Përgjithshëm; kishte Njësitet vartëse: Gardën e Kosovës, 6 Zona Mbrojtëse: Zona I-VI Mbrojtëse; 2 brigada: Brigadën e Xhenios dhe Brigadën e Mbrojtjes Civile; 3 batalione: Batalionin 50 të Ndërlidhjes, Batalionin 90 të Inspektoratit, Batalionin 40 të Mjekësisë; Njësitin 70 Ajror; Komandën e Trajnimit dhe Doktrinës (KTD); Komandën e Logjistikës etj. TMK-ja aktivitetin e vet e shtrinte pothuajse në tërë territorin e Kosovës. Prandaj, për të përmbushur sa më mirë misionin e saj në nevojat e mbrojtjes civile dhe të popullit të Kosovës, është ndarë në gjashtë rajone, të njohura si zona të mbrojtjes (ZM)⁴⁴.

Shikuar nga aspekti i mbrojtjes dhe sigurisë, caktimi i zonave mbrojtëse kishte për qëllim mbulimin e përgjithshëm gjeografik të territorit të Kosovës: Zona I Mbrojtëse (Skenderaj) Zona II Mbrojtëse (Prizren), Zona III Mbrojtëse (Pejë), Zona IV Mbrojtëse (Mitrovicë), Zona V Mbrojtëse (Prishtinë), Zona VI Mbrojtëse (Gjilan). *Zona e Parë Mbrojtëse* ishte e vendosur në 7 lokacione.⁴⁵ *Zona II Mbrojtëse* ishte e vendosur në 7 lokacione⁴⁶. *Zona III Mbrojtëse* ishte e vendosur në 9 lokacione⁴⁷. *Zona IV Mbrojtëse* ishte e vendosur në 6 lokacione⁴⁸. *Zona V Mbrojtëse* ishte e vendosur në 4 lokacione⁴⁹. *Zona VI Mbrojtëse* ishte e vendosur në këto 4 lokacione⁵⁰. *Komanda e Gardës* ishte e vendosur në 3 lokacione⁵¹. *Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së* ishte vendosur në Prishtinë etj⁵². Shtabi i Përgjithshëm kishte *Shërbimin Mbështetës* pranë SHP dhe këto departamente: Departamentin e Personelit⁵³, Departamentin Informativ⁵⁴, Departamentin Operativ⁵⁵, Departamentin e Logjistikës⁵⁶,

⁴⁴ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP.

⁴⁵ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Zona I Mbrojtëse.

⁴⁶ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Zona II Mbrojtëse.

⁴⁷ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Zona III Mbrojtëse.

⁴⁸ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Zona IV Mbrojtëse.

⁴⁹ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Zona V Mbrojtëse.

⁵⁰ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Zona VI Mbrojtëse.

⁵¹ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Komanda e Gardës.

⁵² ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP.

⁵³ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Vendimi nr.prot.01/1082/18, 22.11.2000.

⁵⁴ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Vendimi nr.prot.01/1022/22, 22.11.2000.

⁵⁵ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Vendimi nr.prot.01/1082/32, 22.11.2000.

⁵⁶ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Vendimi nr.prot.01/1082/40, 22.11.2000.

Departamentin për Marrëdhënie Civile-Ushtarake⁵⁷, Departamentin e Komunikimit⁵⁸, Departamentin e Trajnimit dhe Stërvitjes⁵⁹, Departamentin e Menaxhimit dhe Resurseve⁶⁰, dhe Inspektoratin⁶¹. Komandant i TMK-së ishte emëruar gjenerallejtant Agim Çeku.




Figura 2. *Struktura e TMK-së.*

Strukturën numerike të TMK-së e përbënin: 5 052 pjesëtarë të uniformuar (10% minoritarë), 3 052 pjesëtarë aktivë, 2 000 pjesëtarë rezervë dhe 100 punonjës civilë. Struktura e TMK-së ishte multietnike e përbërë prej dy gjinive dhe prej të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, si: serbë, boshnjakë, romë, turq, ashkali, kroatë, goranë etj., të cilët përbënin 10% të strukturës së përgjithshme të TMK-së⁶². Strukturën organizative të TMK-së e përbënin: Shtabi Përgjithshëm i TMK-së, 6 zona mbrojtëse, Garda e Kosovës, Komanda e Trajnimit dhe Doktrinë (KTD), Komanda e Logjistikës si dhe njësitet qendrore të SHPTMK-së , të

⁵⁷ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Vendimi nr.prot.01/1082/49, 22.11.2000.

⁵⁸ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Vendimi nr.prot.01/1082/54, 22.11.2000.

⁵⁹ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Vendimi nr.prot.01/1082/59, 22.11.2000.

⁶⁰ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Vendimi nr.prot.01/1082/13, datë 22/11.2000.

⁶¹ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Vendimi nr.prot.01/1082/27, datë 22/11.2000.

⁶² *Analiza vjetore e JI të SHP i TMK*, viti 2005.

paraqitura në organogramin në vijim.⁶³

Sistemi i gradave në TMK përbëhet prej 12 niveleve të cilat ishin grada tipike ushtarake. Ato ishin dy nivele: *oficerët*: gjenerallejtnant, gjeneralmajor, gjeneralbrigade, kolonel, nënkolonel, major, kapiten, toger; *nënoficerët*: kapter, rreshter, tetar dhe ushtar.

Gjatë procesit të formimit dhe konsolidimit, TMK-ja ballafaqohej me shumë sfida. Që ta kuptojmë se me çfarë sfidash konkretisht ballafaqohej kjo organizatë, mjafton ta lexojmë së paku një *Raport* të komandantit të TMK-së, gjeneral Agim Çekut, që ua kishte dërguar anëtarëve të Këshillit të Përkohshëm Administrativ të Kosovës (KPA): Hashim Thaçi, Ibrahim Rugova dhe akademik Rexhep Qosja. Aty flitet gjerësisht për "*Gjendjen aktuale dhe problemet në Trupat Mbrojtëse të Kosovës*".⁶⁴ Sipas atij *Raporti*, që mban datën 9 maj 2000, procesi i ngritjes, ndërtimit dhe organizimit të TMK-së, përkundër problemeve, vështirësive si dhe pengesave, konstatohej se ka rezultuar i suksesshëm, sepse, siç thuhet në atë *Raport*, TMK tashmë ishte formuar, e kishte marrë formën e duhur dhe pamjen e vet si institucion që përbëhet dhe drejtohet nga shqiptarët, si vlera e vetme, më e çmueshme dhe e prekshme e Kosovës së pasluftës. Mirëpo, siç thuhet në vazhdim të atij *Raporti*, disa përfaqësues të Bashkësisë Ndërkombëtare nuk ishin të interesuar që procesi i zhvillimit të TMK-së të ecë në rrugën e duhur për të siguruar një sistem të forcës mbrojtëse, e cila do të garantonte paqe, stabilitet dhe siguri të përhershme dhe se do të quhej Ushtria e Kosovës. Një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare ishte e interesuar të mos ndodhte një gjë e tillë, prandaj në shumë raste pengonin, ngadalësonin dhe neglizhonin ngritjen, zhvillimin dhe organizimin e TMK-së. Gjithnjë sipas *Raportit*⁶⁵, pengesat shfaqen në mungesë të përkrahjes, financimit dhe ndihmesave të ndryshme. Problemet kryesore ishin konkrete. Prandaj, komandanti i TMK-së, me anë të kësaj shkrese, kërkonte që të bëhej: emërimi i bashkëkryesuesit të Departamentit për Siguri dhe Emergjencë në KPA, sepse TMK ndjente mungesën e hierarkisë, të përgjegjësisë vertikale dhe përfaqësimit të TMK-së në UNMIK. Këtë departament, komandanti i TMK-

⁶³ *Analiza vjetore e Departamentit të Personelit (J1) të Shtabit të Përgjithshëm (SHPTMK)*, Prishtinë, 2005.

⁶⁴ Trupat Mbrojtëse të Kosovës-Shtabi i Përgjithëm: *Raport mbi realizimin e detyrave me rëndësi të veçantë për TMK-në*, nr.prot.01/385, datë 16.08.2000, Komandanti i TMK-së, gjenerallejtnant Agim Çeku.

⁶⁵ Trupat Mbrojtëse të Kosovës-Shtabi i Përgjithëm: *Raport mbi realizimin e detyrave me rëndësi të veçantë për TMK-në*, nr.prot.01/385, datë 16.08.2000, Komandanti i TMK-së, gjenerallejtnant Agim Çeku.

së e konsideronte si institucion epror me kompetenca të Ministrisë së Mbrojtjes.

Po ashtu kërkohet të zgjidhet statusi i pjesëtarëve të TMK-së, statusi i invalidëve të luftës, familjeve të dëshmorëve dhe veteranëve. Kërkohej, gjithashtu, zgjidhja e çështjes së financimit të TMK-së, sepse mjetet që i ndante UNMIK-u, e nga buxheti nuk mjaftonin të përmbushnin kërkesat as për një muaj. Mungesa e këtyre mjeteve, sipas Raportit në fjalë, nuk siguronin as ushqimin e pjesëtarëve, derivatet, mirëmbajtjen e objekteve, materialin shpenzues për zyre dhe objekte, pagesën e rrymës, ujit, telefonit, mbeturinave etj. Pikë tjetër shqetësuese për të cilin komandanti i TMK-së, gjeneral Agim Çeku i raportonte KPA-së, ishte mënyra se si trajtoheshin pjesëtarët e TMK-së nga policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i. Pjesëtarët e TMK-së nuk trajtoheshin as si qytetarë, por “si të tjerë”. Prandaj, gjeneral Çeku, me anë të këtij Raporti, kërkonte edhe përkrahje për të ngritur identitetin e TMK-së, duke filluar nga sigurimi i uniformave të përshtatshme dhe shenjave të tyre dalluese me të cilat mund të identifikoheshin ushtarët. Sepse UNMIK-u refuzonte të paguante një shumë të caktuar për uniforma të cilat ishin përgatitur në një fabrikë tekstili në Kosovë. Ani se UNMIK-u fillimisht kishte lejuar që targat e automjeteve të TMK-së të ishin të ndryshme nga ato civile, ata prapë kërkonin që targat të jenë si të gjithë qytetarëve.

Një pikë tjetër për të cilën kërkohet ndihmë nga anëtarët shqiptarë të KPA-së, ishte edhe çështja e gradave. TMK kërkonte që gradat të njihen si grada ushtarake, kurse UNMIK-u nuk lejonte. Tendenca e hapur e KFOR-it dhe UNMIK-ut bashkërisht, sipas këtij Raporti, ishte që TMK të “civilizohet” në atë shkallë sa përbrenda të mos kishte asgjë ushtarake. Tendencë tjetër e UNMIK-ut dhe KFOR-it ishte që numri i lejuar i armëve të zvogëlohet sa më shumë që është e mundur, me qëllim që një ditë të mos ketë asnjë armë. Më tutje kërkohet që me rastin e hartimit të Kushtetutës së Kosovës, TMK-së t’i caktohet statusi i qartë në përputhje me çdo forcë mbrojtëse. Lidhur me këtë kërkohet të nxirrej një ligj i veçantë, me të cilin përcaktohet që e gjithë prona e ish-Ushtrisë Jugosllave (UJ), si pronë shtetërore, t’i jepej në përdorim TMK-së, siç janë: kazermat, shtëpitë e ish-Ushtrisë Jugosllave, depot, banesat dhe kapacitetet e ndryshme të tjera. Kërkohej, gjithashtu, që çështja e emërimeve dhe shkarkimeve në TMK të mos mbetet vetëm në kompetencat e PSSP-së, por të trajtohet edhe në KPA.⁶⁶

⁶⁶ Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Fondi: TMK, Dosja SHP, *Gjendja aktuale dhe problemet në Trupat Mbrojtëse të Kosovës*, nr.prot 230, datë 9.05.2000, Prishtinë.

Duket se kjo shkresë dërguar anëtarëve (shqiptarë) të KPA-së, kishte pasur efekt. Sepse, sipas një takimi të përbashkët, të mbajtur më 7 korrik 2000, mes komandantit të KFOR-it dhe stafit të tij dhe komandantëve të Brigadave Shumëkombëshe, përfaqësuesve të UNMIK-ut dhe komandantit të TMK-së me bashkëpunëtorët dhe komandantit të Gardës së Kosovës, komandantët e zonave dhe njërive varëse, lidhur me ngritjen e besimit, bashkëpunimit, respektit dhe ndihmës së ndërsjellë, ishte arritur rezultati i shkëlqyeshëm në pikëpamje të eliminimit të plotë të mospërbushjeve nga ana e pjesëtarëve të TMK-së⁶⁷.

Me fjalë të tjera, gjatë një sërë takimeve me KFOR-in dhe UNMIK-un ishin zgjidhur disa çështje me rëndësi të veçantë. Kështu ishin siguruar 200 armë (AK-47) për sigurimin e objekteve, 1 800 armë të deponuara për TMK-në, fillimisht në një vend në Prishtinë, kurse ndarja bëhej më vonë. Prej tyre 50 pushkë gjysmautomatike që shërbenin për kompaninë ceremoniale, kurse lejet e armëve do të vazhdonin deri më 15 dhjetor 2 000. Policia ushtarake e TMK-së të ishte e armatosur me armë brezi. Ishte aprovuar edhe *Rregullorja e Inspektoratit*, por edhe ishte shtyrë afati i mbajtjes së komponentes rezervë në TMK.⁶⁸ Kësisoj, TMK, me gjithë vështirësitë dhe pengesat që kalonte gjatë procesit të konsolidimit, arriti t'i ruante në pronësi të saj edhe një sasi të armëve.

Pra, TMK posedonte edhe një numër armësh: armë për mbrojtjen e objekteve (kazerma) ku ishin vendosur pjesëtarët e TMK-së; armë brezi për mbrojtje personale, numri i të cilave ishte i kufizuar; armë për njësitin ceremonial, armë këto “me veprim me shul ose armë gjysmautomatike” dhe 1 800 armë të deponuara në kazerma të cilat mirëmbaheshin nga TMK, por ishin nën kontroll të përbashkët me KFOR-in. Lista e armëve të gjata që i kishte në përdorim TMK-ja arrinte numrin 200, të cilat ishin shpërndarë nëpër njësi të ndryshme. Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së kishte 6 armë të gjata, Zona I Mbrojtëse (25), Zona II Mbrojtëse (25), Zona III Mbrojtëse (26), Zona IV Mbrojtëse (27), Zona V Mbrojtëse (29), Zona VI Mbrojtëse (31), kurse njësitë vartëse të SHP (31). Njësitë vartëse të SHP të TMK-së kishin këtë sasi armësh të gjata: Garda e Kosovës (16), Akademia e Liderëve (1), Batalioni i Xhenios (3), Batalioni 50 i

⁶⁷ Trupat Mbrojtëse të Kosovë-Shtabi i Përgjigjëm: *Raport mbi realizimin e detyrave me rëndësi të veçantë për TMK-në*, nr.prot.01/385, datë 16.08.2000, Komandanti i TMK-së, gjenerallejtant Agim Çeku.

⁶⁸ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, *Raport mbi realizimin e detyrave me rëndësi të veçantë për TMK-në*, nr.prot. 01/385, datë 16.08.2000, Prishtinë.

Ndërlidhjes (3), Batalioni 8-MKABM (3), Batalioni 40 mjekësor (2) dhe Eskadrila 70 e Helikopterëve (2).⁶⁹

Që nga formimi i zonave mbrojtëse dhe njësive qendrore të SHP, pjesëtarët e TMK-së morën pjesë në shumë aktivitete dhe ngjarje të cilat përfshihen në tri kategori: trajnime dhe specializime brenda dhe jashtë vendit; reagimi në situata reale emergjente dhe, ofrimi i ndihmave në projektet humanitare për komunitetin. Pjesëtarët e TMK-së janë trajnuar në lëmi të ndryshme nga ekspertë të ndryshëm vendorë (profesorë universiteti) e ndërkombëtarë, ndërsa kontributin më të madh në këtë aspekt e kanë dhënë IOM-i dhe KFOR-i. Fushat e specializimit ishin: kërkim-shpëtim, ndihmë e parë, deminim, largim i materieve të rrezikshme kimike, reagim i shpejtë ndaj katastrofave natyrore dhe industriale, topografi, udhëheqje dhe komandim, ushtrime simulative, informatikë, kurse të gjuhëve të huaja etj. Nga ngjarjet më të rëndësishme në fushën e trajnimit duhet përmendur: pesë ushtrime të mëdha fushore (Shqiponja 1-5) duke u përfshirë të gjitha njësitet e TMK-së dhe një numër të madh demonstrimesh fushore (shpesh në bashkëpunim me KFOR-in) nga aspekti i reagimeve në rast të krizave. Pjesëtarët e TMK-së demonstruan aftësitë e tyre edhe jashtë vendit: dy herë në Afrikën e Jugut, dy herë në Republikën Çeke, një herë në Turqi, një herë në garën botërore në nxjerrjen e viktimave në Pragë të Çekisë, njëherë në Britaninë e Madhe si dhe një herë në Shqipëri (tragjedia e Gërdecit) duke ju ofruar asistencë në fushën e deminimit.⁷⁰

Modeli i zhvillimit profesional të oficerëve dhe nënoficerëve përfshinte këto kurse: Kursi bazik ose kursi hyrës fillestar (tetar – ushtar gardist), Kursi themelor i zhvillimit dhe udhëheqësve (kapter-rreshter), Kursi themelor për oficer (kapiten - toger), Kursi i oficerëve të karrierës (nënkolonel-major), Kursi i komandës dhe stafit komandues (gjeneral-kolonel).⁷¹

Oficerët e TMK-së kishin kryer trajnime edhe në Ukrainë në lëmin e “Mbrojtjes kimiko-atomiko-biologjike”⁷².

⁶⁹ ASHAK, Fondi: TMK, Dosja SHP, Lista e armëve të gjata që kishte në dispozicion TMK.

⁷⁰ Historia e TMK-së, *Doracak i AM/KDS*, Prishtinë, f. 16.

⁷¹ Analiza vjetore e Departamentit të Personelit (J1) të Shtabit të Përgjithshëm (SHPTMK), Prishtinë, 2005.

⁷² *Rilindja*, 19.09.2000.

Konkluzione

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, pavarësisht paragjyqimeve e gjyqimeve, pavarësisht se u përballë me ushtrinë, policinë dhe forcat tjera të sigurisë së Serbisë dhe Jugosllavisë, ajo doli fituese, sepse Kosova u çlirua. Edhe pse Kosova u çlirua, kjo organizatë dhe pjesëtarët e saj nuk u trajtuan si duhet. UÇK fillimisht u demilitarizua e pastaj u transformua në Trupa Mbrojtëse të Kosovës. As procesi i demilitarizimit e as i transformimit nuk ishte i lehtë. Posaçërisht procesi i transformimit hasi në pengesa të shumta. Fatkeqësisht, faktori relevant ndërkombëtar, nuk lejoi që çlirimtarja e Kosovës, UÇK-ja, të bëhej ushtria e cila do ta çonte Kosovën në pavarësi sepse, me sa duket *“zyrtarët e Beogradit kishin rënë dakord të lejonin vendosjen e paqeruajtësve të NATO-s në Kosovë me kusht që UÇK-ja të çmilitarizohej dhe shpërbëhej”*.⁷³

Pavarësisht kësaj u arrit njëfarë kompromisi për transferimin e saj në Trupa Mbrojtëse të Kosovës. Edhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës nuk e patën më të lehtë rrugëtimin e tyre drejt konsolidimit të tyre dhe drejt pavarësisë së Kosovës. Pavarësisht se TMK ishte trashëgimtare e UÇK-së, pavarësisht se ajo ishte gjysmëcivilile e gjysmëushtarake, kaloi nëpër sfida të shumta. Pavarësisht pengesave të të gjitha këtyre arriti të shndërrohet në institucionin më kredibil për qytetarët e Kosovës. Me punën dhe profesionalizmin e saj e ndërtoi vendin, e çoi Kosovën në pavarësi. Edhe pse ishte institucion model i funksionimit në Kosovë, ajo pati fat edhe më të keq se UÇK-ja, sepse ajo nuk u transformua në ndonjë organizatë tjetër politike e as ushtarake, as nuk u bë Ushtri e Kosovës, por u shpërbë na janar të vitit 2009.

E rëndësishme është se edhe UÇK-ja, edhe TMK-ja e kanë kryer misionin e tyre historik. Mirëpo, nëse për UÇK-në janë shkruar e botuar qindra e mijëra faqe nëpër gazeta, revista e libra, nëse janë bërë dokumentarë e nëse janë mbrojtur teza disertacionesh në Kosovë dhe Evropë, për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, edhe pse ka qindra e mijëra dokumente tashmë të arkivuar, sepse TMK-ja la pas vetës një arkivë të pasur, nuk është shkruar dhe botuar ndonjë punim profesional, shkencor nëpër ndonjë gazetë a revistë që vlen të lexohet; nuk janë shkruar e botuar as monografi, nuk janë mbrojtur as tema masteri e lëre më disertacione doktoratash. Së paku mua nuk më ka rënë në dorë diçka e tillë. Unë kam pasur rastin t'i shfletoj disa dokumente arkivore që ruhen në Agjencinë

⁷³ By R. Jeffrey Smith, *NATO, Kosovo Rebels Reach Accord*, Washington Post Foreign Service Tuesday, September 21, 1999, Page A1.

Shtetërore të Arkivave të Kosovës, por që janë tërësisht të pasistemuara. Ato dokumente dëshmojnë më së miri se çfarë ishin Trupat Mbrojtëse të Kosovës.

Miftar KURTI

SUMMARY

DEMILITARIZATION OF THE KOSOVO LIBERATION ARMY AND ITS TRANSFORMATION INTO THE KOSOVO PROTECTION CORPS

The “Kosovo Liberation Army” (KLA) was a political-military organization. It arose at a pivotal moment, at a very strenuous period for Kosovo. Its mission was the liberation and independence of Kosovo. Although, revealed publicly in commemoration on November 28, 1997, in a village Llaushë in Drenica, immediately rise to become a decisive factor in liberating Kosovo. According to the Rambouillet Agreement (February-March 1999), UN Resolution 1244 (June 10, 1999) and the “Agreement on its demilitarization and transformation” (June 20, 1999), it was first demilitarized and then transformed into the “Kosovo Protection Force”, thus successfully completion of its historic mission.

On September 1999, after several days of difficult negotiations between the local (KLA leaders) and international (NATO) factors, KLA was transformed and succeeded by the KPC. Thus concluded its mission. KPC, likewise, had various challenges on the process of their formation and consolidation. Despite numerous obstacles, KPC managed to become the most credible institution in Kosovo, an exemplary institution. Although, it had a modest number of members (3000 active and 2000 reserves), it contributed immensely for the reconstruction and the independence of Kosovo. In January 2009, KPC was dissolved. As the continuation of this organization heritage, the Kosovo Security Force (KSF) was formed, based also on the transformation of its leadership from KPC, and previously from KLA. The KLA and KPC have fulfilled their historic mission, as Kosovo would not be free or independent without the existence of these two organizations.